

CYTHRIN MAX

PRODUKT PER MBROJTJEN E BIMEVE



GHS02



GHS05



GHS07



GHS08



GHS09

“Rrezik” “Helmues (T)”

PMB ME RREZIK TË LARTË

TË PËRDORET VETËM NGA PËRDORUES PROFESIONISTË

“Lexo fletudhëzuesin para përdorimit”

Insekticid me përbërje piretroide, me spektër të gjerë veprimi, duke luftuar me sukses insekte të grupeve të ndryshme sistematike e me mënyra të ndryshme jetese. Karakterizohet nga veprimi i fuqishëm kontakti dhe ngrënieje.

Përmbajtja: Cypermethrin 47.46 g (500 g/l).

Formulimi: Koncentrat i Emulsionueshem (EC).

GRUPI 3A INSEKTICID

Deklaratat e rrezikut:

H302+H332- E dëmshme nëse gëlltitet ose thithet;

H304- Mund të jetë fatale nëse gëlltitet dhe përshkon rrugët e frymëmarrjes;

H315- Shkakton acarim të lëkurës;

H318- Shkakton dëmtim serioz të syve;

H335- Mund të shkaktojë acarim të rrugëve të frymëmarrjes;

H336- Mund të shkaktojë përgjumje ose marramendje;

H373- Mund të dëmtojë organet nëpërmjet ekspozimit të zgjatur ose të përsëritur;

H410- Shumë toksike ndaj jetës ujore me efekte të përherëshme;

EUH401: Për të shmangur rreziqet për shëndetin e njeriut dhe mjedisin, ndiqni udhëzimet për përdorim.

Deklaratat parandaluese:

P210- Mbajeni larg nga nxehësia, sipërfaqet e nxehta, shkëndijat, flakët e ekspozuara dhe nga burime të tjera të ndezshme. Ndalohet pirja e duhanit;

P260- Evitoni frymëmarrjen pluhur/tym/gaz/avuj/avuj/sprej;

P280- Vishni doreza mbrojtëse/veshje mbrojtëse/mbrojtëse për sytë/fytyrën;

P301+P310- NËSE GËLLTITET: telefononi menjëherë një QENDËR PËR TRAJTIMIN E HELMIMIT ose një doktor;

P302+P352- NËSE BIE NË KONTAKT ME LËKURËN: Lahu me shumë ujë;

P305+P351+P338- NËSE BIE NË KONTAKT ME SYTË: shpëllajini sytë me ujë në mënyrë të kujdesshme për disa minuta. Hiqini lentet e kontaktit, nëse keni dhe nëse është e lehtë për t'i hequr. Vazhdoni me shpëllarjen;

P331- Evito të vjellat;

P501- Hidheni përmbajtjet/ena to të rrezikshme ose pika grumbullimi të veçanta të mbeturinave në përputhje me rregulloren lokale, rajonale, kombëtare dhe/ose ndërkombëtare;

Mbajeni në vende të sigurta dhe të paarrtshme nga fëmijët;

Ruajeni në vende të thata dhe të freskëta, larg ushqimeve dhe pijeve për njerëzit si dhe ushqimeve për blegtorinë;

Evitoni kontaktet e zgjatura të syve dhe lëkurës me preparatin.

H226- Avull dhe lëndë të lëngshme të ndezshme.

Udhëzime për ndihmën e parë dhe këshilla për mjekun:

INFORMACION PËR MJEKUN: Simptomat: Bllokoni transmetimin nervor duke mbi stimuluar në mënyrë parastinaptike mbaresat neuronale. Ndjeshmëri e veçantë edhe nga pacientët alergjikë dhe disa fëmijë astmatikë. Simptomat e SNQ: dridhje, konvulsione, ataksi; acarim i rrugëve të frymëmarrjes: rrjedhje e hundës, kollë, bronkospazma dhe dispne; reaksionet nxitëse alergjike: anafilaksi, hipertermi, djersitje, edemë e lëkurës, kolaps vaskular periferik. Terapia: simptomatike dhe reanimuese. Kujdes: konsultohuni me një qendër helmet.

Përdorimi:

Në grure, elb, theker, tritikale, tërshëre, foragjere graminore, kundër afideve vektorëve të BYDV, afideve të tjera, krimbit tel (*Agrotis segetum*), tortricideve (*Cnephasia* spp.), lemes (*Oulema* spp.). *Crioceris* spp., me 50 ml/ha;

Në misër foragjere dhe kokërr, kundër piralideve (*Ostrinia nubilalis*), *Sesamia cretica*, noktuideve (*Heliothis armigera*), *Agrotis segetum*, rrenje ngrenesit të misrit (*Diabrotica* spp.), me 150 ml/ha;

Në kolez dhe sinap, kundër *Psylliodes chrysocephala*, *Phyllotreta atra*, hundegjatit (*Ceuthorrhynchus napi*), *Cecidomia*, *Dasyneura brassicae*, *Meligethes aeneus*, *Tropinota hirta*, me 50 ml/ha;

Në brokoli, lulelaker, laker kokë, kundër *Phyllotreta* spp., buburecit patates (*Leptinotarsa decemlineata*), krahebardhes (*Trialeurodes vaporariorum*), afideve (*Myzus* spp. dhe *Aphis* spp.), rrenje ngrenesit të misrit, gjinkalles (*Empoasca* spp.), tripsit, noktuideve, me 100 ml/ha;

Në bizele dhe fasule, kundër tripseve, *Sitona lineatus*, afideve, noktuideve, me 100 ml/ha;

Në asparagus, kundër *Crioceris asparagi*, me 100 ml/ha, vetëm pas vjeljes;

Në angjinat, kundër afideve, noktuidit të angjinës (*Gortyna xanthenes* - *G. flavago*), me 100 ml/ha;

Në qepë, hudhra, presh, kundër noktuideve, tenjës së preshit (*Acrolepiopsis assectella*), buburecit patates, afideve (*Myzus* spp. dhe *Aphis* spp.), rrenje ngrenesit të misrit, gjinkalles, tripsit, krahebardhes, me 100 ml/ha;

Në pjepër, kungujt, shalqi dhe gungullore të tjera, kundër noktuideve, buburecit patates, afideve (*Myzus* spp. dhe *Aphis* spp.), rrenje ngrenesit të misrit, gjinkalles, tripsit, noktuideve, me 100 ml/ha; gjinkalles, tripsit, krahebardhes, me 100 ml/ha;

Në domate dhe patëllxhan, kundër noktuideve, buburecit patates, afideve (*Myzus* spp. dhe *Aphis* spp.), rrenje ngrenesit të misrit, gjinkalles, tripsit, krahebardhes, me 100 ml/ha;

Në panxhar sheqeri dhe foragjer, rutabaga dhe rrepe, kundër *Conorhynchus mendicus* dhe *Lixus junci*, afideve (*Myzus* spp. dhe *Aphis* spp.), krahebardhes, *Cassida vittata*, noktuideve, tenjes patates, me 100 ml/ha;

Në karrota, selino, rrepka, majdanoz, kundër noktuideve, *Phyllotreta* spp., bubrecit të patates, afideve (*Myzus* spp. dhe *Aphis* spp.), gjinkalles, tripseve, krahebardhes, me 100 ml/ha;

Në patate, kundër afideve (*Myzus* spp. dhe *Aphis* spp.), tenjes (*Phthorimaea operculella*), bubrecit të patates, me 80-100 ml/ha;

Në rushin e tavolines dhe të veres, kundër tenjave (*Lobesia botrana*, *Eupoecillia ambiguella*), tortricideve (*Sparganothis pilleriana*), cigareperdrethesit (*Byctiscus betulae*), *Scaphoides titanus*, gjinkelles, me 60 ml/ha;

Në ullinj, kundër tenjes (*Prays oleae*) (breznia antofage dhe karpofage), mizes (*Bactrocera oleae*), tenjës jeshile (*Palpita unionalis*), me 8-10 ml/hl; mos e kaloni dozën 100 ml/ha për një aplikim;

Në jonxhë, kundër krahebardhes, krysolmelides së zezë (*Colaspidea atrum*), hundegjatit (*Phytonomus variabilis*), afideve (*Myzus* spp. dhe *Aphis* spp.), tripsit, noktuideve, me 100 ml/ha;

Në duhan, kundër *Cassida vittata*, afideve (*Myzus* spp. dhe *Aphis* spp.), krahebardhes, tripsit, noktuideve, me 100 ml/ha;

Në lule dhe bime dekorative, kundër afideve, *Cacoecimorpha pronubana*, larves jeshile të karafilit (*Epichoristodes acerbelli*), tripseve, krahebardhave, minueseve, noktuideve, me 10-20 ml/hl. Mos e kaloni dozën prej 100 ml/ha për aplikim;

Në plepa në fidanishte dhe bimë të reja, kundër afideve, *Saperda carcharias* dhe *Cryptorhynchus lapathi*, me 10 ml/hl. Mos e kaloni dozën 100 ml/ha për aplikim;

Në pylltari në fidanishte, kundër limantrias (*Lymantria dispar*), me 4 ml/hl; mos e kaloni dozën prej 100 ml/ha për aplikim; Kundër karkalecave të gjitha specieve në të gjitha kulturat ku ndeshet infeksioni, duke përdorur 100 ml/hl dhe duke trajtuar kur dëmtuesi është në moshat e para dhe pa filluar imigrimin masiv. Përdoret gjithashtu duke përgatitur ushqime të helmuara me 100 g Cythrin Max për 1 kg hime ose foragjere të njoma.

Vërejtje për përdorimin:

Trajtimet fillojnë me shfaqjen e infeksioneve të para. Përzihet me të gjitha fungicidet me përjashtim të atyre me reaksion alkaline. Mos kryeni me shume se dy trajtime/sezon. Mos trajtoni në ditë me erë. Mos trajtoni kur bimësia dhe barërat spontane janë në lulëzim. Në rast të përzierjes me formulime të tjera, duhet të respektohet perioda më

e gjatë e karences. Kryeni një maksimum prej 1 trajtimi në vreshta dhe 2 në të gjitha kulturat e tjera ne interval minimal 2 javë për grurin, elbin, thekrën, triticalet, tërshërën, kolzen, mustardë dhe 10 ditë për të gjitha kulturat e tjera).

Fitotoksiciteti:

Nuk është fitotoksik kur përdoret me dozat dhe sipas rekomandimeve në këtë etiket.

Ndikimi në ekosistem:

Toksike për bletët. Mos e përdorni produktin gjatë lulëzimit.

Mos e ndotni ujin me produktin ose enën e tij. Për të shmangur kontaminimin e ujërave nëpërmjet sistemeve të kullimit të ujit nga fermat bujqësore mos i pastroni mjetet e aplikimit në afërsi të ujërave sipërfaqësore. Mbrojtja e organizmave ujore: Për të mbrojtur organizmat ujorë, respektoni distancat e mëposhtme nga uji sipërfaqësor: 5 m kur spërkatim te gruri, thekra, triticalet, elb, tërshërë, kolze, pambuk, mustard; 10 m (5 m me grykë anti-drift me 50% reduktim drifti) kur spërkatim ne jonxhe, bishtajore, patate, panxhar sheqeri dhe foragjer, duhan, perime, ornamentalet nene 50 cm lartësi; 15 m (5 m me grykë anti-drift me 50% reduktim drifti) në misër; 30 m vresht (5 m me grykë anti-drift 50% reduktim drifti), ullinj (20 m me grykë anti-drift me 50% reduktim drifti).

Karenca:

28 ditë për grurin, elbin, thekrën, tritikalet, tërshërën, në misrin deri në lulëzimin e plotë; 21 ditë për kolzen, mustardën, pambukun dhe hardhinë; 14 ditë për panxhar sheqerin dhe atë foragjere, panxharin e kuq, rutabaga, rrepën dhe duhani; 7 ditë për jonxhën; 3 ditë për të gjitha kulturat e tjera përveç plepit, ulliri (bimët jo në prodhim), pemët dekorative dhe pyjore për të cilat nuk ka interval sigurie.

Magazinimi:

Ruajeni të mbyllur në ambalazhin origjinal, në ambient të thatë, të ventiluar mirë dhe sigurojeni nga rreziku i zjarrit. Preparati të mos mbahet në diell.

Numri dhe data e regjistrimit: 790, datë 15.08.2022;

Sasia neto e PMB-së apo lëndës vepruese, që ndodhet në ambalazhin bazë: Deri 1 lit;

Numri i serisë ose shenja të tjera identifikuese: _____;

Data e prodhimit: _____;

Data e skadencës ose periudha e ruajtjes (sipas kërkesëve të përcaktuara): 2 vjet;

Lloji i ambalazhit bazë: Shishe HDPE dhe COEX;

Emri dhe adresa e kërkuar: Arysta LifeScience Benelux SPRL. **Adresa:** Ougrée, Belgjikë;

Emri dhe adresa e prodhuesit: UPL Europe Ltd. **Adresa:** Warrington, Cheshire, Mbretëria e Bashkuar.